

**RREGULLORE NR. 1999/13**

UNMIK/RREG/1999/13

16 tetor 1999

**PËR LIÇENCIMIN E INSTITUCIONEVE JOBANKARE MIKROKREDITUESE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Duke vepruar në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të rregullimit të institucioneve jobankare të mikrofinancimit në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

**PËRKUFIZIME**

Sipas kësaj rregulloreje:

“Institucion jobankar mikrofinanciar” do të thotë institucion financiar që nuk është bankë, por që angazhohet në veprimtari mikrofinanciare.

“Bankë” do të thotë institucion financiar i cili angazhohet në veprimtarinë e pranimit nga publiku të depozitave në para ose fonde të ngjashme të ripagueshme, duke përfshirë personat fizikë dhe juridikë dhe dhënien e kredive për llogari të vet.

“Institucion mikrofinanciar” do të thotë institucion i cili u jep kredi personave fizikë dhe juridikë në shuma jo më të mëdha se 2,000 marka gjermane në një ekspozim kumulativ ndaj rreziqeve për një huamarrës apo për huamarrës të ngjashëm.

“Kredi” do të thotë çdo zotim për dhënien e një shumë parash në këmbim të së drejtës për ripagesën e shumës së dhënë dhe të papaguar, si dhe të interesit ose pagesave të tjera mbi atë shumë; çdo dhënie në afat të një borxhi; çdo garanci të lëshuar dhe çdo zotim të paparashikuar ose tjetër për të fituar sigurimin e borxhit ose të drejta të tjera të pagesës së një shume parash.

Neni 2

**LICENCIMI I INSTITUCIONEVE JOBANKARE MIKROFINANCIARE**

2.1 Institucionet jobankare mikrofinanciare që dëshirojnë të veprojnë në Kosovë duhet të marrin leje nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

2.2 Veprimtaritë e institucioneve të licencuara sipas kësaj rregulloreje kufizohen në ato të specifikuar në planin e veprimtarive të dorëzuar në përputhje me kërkesat e numruara në neni 3 më poshtë.

Neni 3

### **KËRKESA PËR LICENCË**

Sipas kësaj rregulloreje kërkesat nga institucionet për liçencë duhet të bëhen me shkrim dhe t'i drejtohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilat duhet të përmbajnë informacionet e mëposhtme:

- (a) Emrin, vendbanimin, vendin dhe adresën e veprimtarisë ekonomike (zyra qendrore) të institucionit;
- (b) Emrat e plotë dhe adresat e themeluesve të institucionit;
- (c) Planin operativ me specifikimin e veprimtarive që ka qëllim institucioni të kryejë dhe burimet e financimit për këto veprimtari, duke përfshirë financimet e siguruar nga financues individualë dhe nga burime të tjera;
- (d) Informacionin lidhur me afatin kohor kur jepet financimi dhe kur fillojnë veprimtaritë e institucionit ;
- (e) Informacionin lidhur me afatin kohor kur do të ndërpriten veprimtaritë e institucionit (pesë vjet ose më pak);
- (f) informacionin lidhur me detyrimet e themeluesve për të konfirmuar politikat e institucionit;
- (g) emrin (emrat) dhe mënyrën e përfaqësimit të personave të autorizuar për të kryer veprimet e themelimit të institucionit dhe
- (h) datën dhe vendin e dorëzimit të kërkesës.

Neni 4

### **DISPOZITA TË TJERA**

4.1 Institucioni që merr liçencë sipas kësaj rregulloreje:

- (a) duhet të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë rregulloret dhe urdhresat administrative të UNMIK-ut që kanë të bëjnë me rregullimet bankare në Kosovë;
- (b) nuk u jep kredi themeluesve, drejtorëve, nëpunësve, të punësuarve të vet si dhe personave juridikë të lidhur;
- (c) nuk përdor fjalën “bankë” në emrin e tij dhe

(d) e ka të ndaluar të pranojë depozita.

4.2 Në asnjë rast institucioni nuk duhet të tejkalojë 10 për qind të financimit total të vënë në dispozicion të institucionit për pasuri të patundshme dhe përmirësime të pronës së marrë me qira.

Neni 5  
**ZBATIMI**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë direktiva dhe urdhra administrativë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 6  
**LEGJISLACIONI NE FUQI**

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me rregullimin e institucioneve jobankare mikrofinanciare që bie në kundërshtim me të.

Neni 7  
**HYRJA NE FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 16 tetor 1999.

***Bernard Kouchner,***  
***Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm***